

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa, kryetare, Valdete Daka dhe Nesrin Lushta, anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurve D.J. nga Shtërpca, N.S. nga Shtërpca dhe M.P. nga fshati B., komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës, të paraqitur kundër aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.95/2017 datë 31.07.2017, dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.783/2017 datë 9.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 15.2.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pranohet si e bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, **konstatohet** se me aktvendimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.95/2017 datë 31.7.2017 dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.783/2017 datë 9.10.2017, është shkelur dispozita e nenit 384 par.1 nënpar.1.12 të KPPK-së, në favor të pandehurve D.J., N.S. dhe M.P.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.95/2017 datë 31.7.2017, është hedhur aktakuza e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.27/2016 datë 8.9.2017, e ushtruar kundër të pandehurve D.J., N.S. dhe M.P. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje keqpërdorimi i pozitës apo autoriteti zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin, PN.nr.783/2017 datë 9.10.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së Ligjit penal në dobi të të pandehurve, me propozim që kërkesa të aprovohet dhe këto shkelje të konstatohen .

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes në pajtim me dispozitat e nenit 435 par.1 dhe 436 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Prokurori i Shtetit në kërkesë pretendon se me aktvendimet e kundërshtuar janë shkelur dispozitat e procedurës penale të KPPK, dhe atë nga fakti se aktvendimet nuk janë përpiluar komform nenit 370 par.7 të KPPK. Kjo nga fakti se arsyetimet lidhur me faktet vendimtare nuk përkojnë me shkresat e çështjes dhe se arsyetimet janë në kundërtënie me dispozitivin e aktvendimeve.

Në kërkesë pretendohet se në aktvendime nuk janë dhënë arsye lidhur me faktet vendimtare sepse fare nuk i janë referuar Udhëzimit Administrativ nr.03/2008 për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës ku shprehimisht theksohet se automjetet zyrtare nënkuptohen automjetet që janë në pronësi apo në përdorim të Qeverisë së Kosovës dhe se kërkesën për përdorim të përkohshëm të këtyre automjeteve mund ta ushtroj vetëm nëpunësi civil, e në rastin konkret kërkesën e ka parashtruar një kompani private si dhe faktin se vetëm Qeveria e Kosovës vendos që automjeti që i përket Qeverisë të shitet apo ti jepet në përdorim një institucioni tjetër.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë përgjigje ka dhënë mbrojtësi i të pandehurit D.J., avokati D.V., duke konsideruar se në arsyetim të kërkesës askund nuk përcaktohen shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale por vetëm bëhet parafrazimi i nenit 384 të KPPK. Po ashtu në përgjigje mbrojtësi konsideron se kërkesa më shumë i referohet gjendjes faktike duke konsideruar se në Gjykatën Supreme nuk mund ushtrohet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë sa i përket vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike e konform nenit 432 par.2 të KPK. Më tutje, në përgjigje mbrojtësi konsideron se në veprimet e të pandehurit duhet të ekzistoj qëllimi që vetit t' i siguroj përfitim material apo t' i shkaktoj dëm tjetrit me qëllim që të përmbushen elementet e veprës penale, e në rastin konkret deri te kjo nuk ka ardhur meqenëse automjeti që është objekt i aktakuzës, i vënë në përdorim të përkohshëm disa muaj, është kthyer në gjendje të rregullt, me çka edhe nuk është shkaktuar as një dëm dhe nuk është bërë përfitim material. Nga të gjitha këto mbrojtësi propozoi që të refuzohet kërkesa e Prokurorit të shtetit të Kosovës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, pretendimet nga kërkesa se janë shkelur dispozitat e procedurës penale të KPPK-së në favor të të pandehurve qëndrojnë e nga këto arsye:

Nga shkresat e çështjes dhe aktvendimet e kontestuara rezulton se ndaj të pandehurve është hedhur aktakuza e PSRK-së nr. PPS.nr.27/2016 datë 15.3.2017 dhe është pushuar procedura penale ndaj tyre për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, meqenëse gjykata e shkallës së parë ka gjetur se në veprimet e të pandehurve nuk janë konsumuar elementet e veprës penale të cekur më lartë,

dhe se të pandehurit në cilësinë e zyrtarëve nuk i kanë kaluar kompetencat e tyre, nuk i është shkaktuar dëm askujt e gjithashtu askush nuk ka përfituar nga këto veprime, aktvendim ky i vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë.

Kjo Gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPPK-së sepse arsyetimi i aktvendimit të kontestuar është në kundërshtim me shkresat e çështjes dhe nuk përmban arsyetim të duhur dhe konkret lidhur me faktet vendimtare të kësaj çështjeje juridike. Aq më tepër arsyetimi nuk ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresa të çështjes dhe nuk është në pajtim me nenin 370 par.7 të KPPK-së. Në shkresat e çështjes gjendet edhe Udhëzimi Administrativ i Qeverisë nr.03/2008 për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës dhe se në nenin 16.3 të po këtij Udhëzimi, Qeveria është ajo e cila vendosë lidhur me faktin se një automjet i Qeverisë të shitet apo t'i jepet në përdorim ndonjë institucioni tjetër. Po ashtu, me të njëjtin Udhëzim- nenin 6 kërkesën për përdorim të përkohshëm të automjetit mund ta ushtrojë vetëm nëpunësi civil e jo një kompani private siç është në rastin konkret. Gjykata e shkallës së parë më tutje në aktvendim fare nuk jep arsyetim se si i pandehuri D.J. në cilësinë e ministrit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK) , nxjerr vendim me të cilin i ndahet në shfrytëzim të përhershëm automjeti, pronë e kësaj Ministrie, Kompanisë Radio KIM me qendër në Çagllavicë, edhe pse sipas këtij Udhëzimi këtë të drejtë e ka vetëm Qeveria. Të gjitha këto gabime i përsëritë edhe gjykata e shkallës së dytë në aktvendimin e kontestuar duke mos dhënë fare arsyetim për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës e për të cilat kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare.

Nga të gjitha këto që u thanë më lartë, u vërtetua se janë shkelur dispozitat e procedurës penale në favor të të pandehurve dhe kjo Gjykatë vetëm e konstaton këtë shkelje , duke mos e prekur vendimin e formës së prerë në raport me këta të pandehur.

Nga arsyet e cekura, konform dispozitës së nenit 438 par. 2 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
PML.nr.335/2017, datë 15.2.2018

Procesmbajtës,
Sherif Krasniqi

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa